



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 26.9.2023

**Lënda:** Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 26.9.2023, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 318/2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Kujtim Luli

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përgjigje të kërtimeve të shkaqeve të ankimit dhe prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, mbështetur në parashikimet e nenit F, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30, 32, 33 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji, me vendim të ndërmjetëm të trupit gjykues, çeli hetimin gjyqësor dhe mori në cilësinë e provës aktet e paraqitura në Kolegj nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur prapësimeve të paraqitura prej tij<sup>1</sup>, duke i dhënë përgjigje edhe kërkesave paraprake të palëve.

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303, të Kodit të Procedurës Civile, Komisioneri Publik, pasi vlerësoi të gjitha shpjegimet, prapësimet dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit dhe të administruara nga Kolegji, në kuadër të këtij gjykimi, në seancat e datës 25.7.2023 dhe 18.9.2023, për secilin shkak ankimi, vlerëson të mbajë qëndrimin se:

**1. Lidhur me shkakun ankimor të deklarimit të pasaktë të shpenzimeve të shkollimit të dy djemve**, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij të paraqitura në seancën e datës

<sup>1</sup> Referuar listës së akteve, numërtuar nga subjekti i rivlerësimit, total 9 akte, në të cilat përfshihen: (i) Shkresë nr. \*\*\* e Drejtorisë Rajonale e Tatimeve Tiranë; (ii) Vendim nr. \*\*\* i Gjykatës Tiranë, për regjistrimin e FSHP-së; (iii) Vendim nr. \*\*\*, datë \*\*.11.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (iv) Vendim nr. \*\*\*, datë \*\*.9.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (v) Vendim nr. \*\*\*, datë \*\*.2.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (vi) Statment nga \*\*\* për pagat e \*\*\*.\*\*\*. (vii) Deklaratë noteriale me vulë apostile, e deklaruesve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*; (viii) Akt-ekspertimi ekonomiko-financiar, datë \*\*.12.2022 dhe (ix) Shkresa me nr. \*\*\*, datë \*\*.9.2023, e Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuar subjektit të rivlerësimit.

18.9.2023, ndër të tjera, pranon pasaktësinë e deklaramit dhe diferencat e konstatuara në shkaqet e ankimit në raport me ato të deklaruara, duke pretenduar se këto pasaktësi janë shëruar në procesverbalin e datës \*\*.3.2016 dhe shpjegimet shtesë të datës \*\*.3.2016, mbajtur pranë ILDKPKI-së, duke prapësuar gjithashtu se ai gjithnjë ka deklaruar brenda limitit të përcaktuar ligjor mbi shpenzimet e shkollimit, përcaktuar nga neni 4 i ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar<sup>2</sup>.

1.1 Komisioneri Publik, pa dashur të kalojë në përsëritje të parashtrimeve të paraqitura prej tij në seancat e mëparshme gjyqësore, vlerëson se mbetet e provuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklaramit të saktë lidhur me pagesat shtesë të shkollimit të fëmijëve në deklaramit periodike vjetore, përkundrejt detyrimit që ka pasur si subjekt deklarues, bazuar në nenin 2/7 të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, sipas së cilit: [...]“*Shpenzim i deklarueshëm*” **është tërësia monetare, e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim, si dhe të tjera shpenzime të këtij lloji, të kryera nga subjekti deklarues**” [...]. Sipas nenit 4, germa “h”, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrim për deklaramin e shpenzimeve të kryera në shumën 5. 000 (USD)/500.000 lekë, detyrim që përkon në vitet 2012-2014, dhe pas ndryshimeve ligjore, pas vitit 2014, shpenzimet e kryera në vlerën 300.000 lekë.

1.2 Shpenzimet shtesë të personave të lidhur, përpos pagesave të tarifave të shkollimit, në vlerësimin e Komisionerit Publik, duhej të ishin deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaramit periodike vjetore, në kuadër të detyrimeve ligjore, me qëllim kontrollin e ligjshmërisë së burimeve në dispozicion, për aq kohë sa shpenzimi i pretenduar në shumën 4.000 USD/vit dhe shpenzimet e paguara sipas faturave të vëna në dispozicion të hetimit, janë pjesë e shpenzimeve të shkollimit të personave të lidhur.

1.3 Në lidhje me pretendimin e subjektit në prapësimet e tij të paraqitura në seancën e datës 18.9.2023 (f. 11, pika ii), mbi mungesën e këtij detyrimi, në referencë të nenit 2 “Përkufizime”, të ligjit nr. 9043/2003, të ndryshuar, pasi pretendon se në shpenzimet e detyrueshme për deklaramit: [...] *nuk përfshihet në mënyrë eksplicite kostoja/shpenzimet për ushqimin/jetesën apo udhëtim* [...], Komisioneri Publik vlerëson se ligjvënësi është treguar i qartë kur, referuar edhe rastit konkret, ka parashikuar: [...] *se shpenzim i deklarueshëm është tërësia monetare e paguar për arsim të kryera nga subjekti deklarues* [...]. Nisur nga mënyra e formulimit të dispozitës, ligjvënësi ka preferuar t’i shmanget përcaktimit të një liste me natyrë shteruese dhe përfundimtare në përcaktimin e natyrës dhe llojit të çdo shpenzimi të kryer nga subjekti deklarues, pasi ato mund të jenë të shumëllojshme dhe të ndryshueshme, duke u treguar eksplicit në detyrimin për deklaramit vjetor të çdo shpenzimi në tërësinë e qëllimit të tij, pra në arsim, mjekim shëndetësor, pushime, arredim, e të tjera të kësaj natyre, me kushtin e vetëm që totali i qëllimit apo i nevojës së shpenzimit të jetë në kufirin e përcaktuar ligjor për deklaramit. Vetëm në këtë mënyrë, subjektet deklaruese mund të kontrollohen objektivisht mbi ligjshmërinë dhe mjaftueshmërinë e burimeve të shpenzimeve të kryera.

---

<sup>2</sup> Për më tepër referohuni aktit “Parashtresë” të subjektit të rivlerësimit, me nr. \*\*\*/\*\* prot., të datës 18.9.2023, f. 6-12, të tij.

1.4 Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë, në kundërshtim për sa kërkon neni 33, pika 5, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

**2. Lidhur me shkakun ankimor mbi pamjaftueshmërinë e të ardhurave për përballimin e shpenzimeve ndër vite,** Komisioneri Publik, sikundër ka mbajtur qëndrim në ankimin e paraqitur dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje, dëshiron të ritheksojë, se në vlerësim të akteve dhe provave të administruara në dosje, ndan gjykim të ndryshëm mbi analizën financiare të kryer nga Komisioni, lidhur me: (i) periudhën e marrë në analizë dhe (ii) zërat e përfshirë në të.

2.1 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij të paraqitura në seancën e datës 18.9.2023, ndër të tjera, mbajti qëndrimin se, lidhur me periudhën e marrë në analizë dhe zërat përkatës, ky shkak ankimi nuk duhet pranuar, pasi [...] *logjika e vazhdimësisë ligjore financiare, që nuk ndërpritet në përfundimin e dy – tre apo shtatë muajve, të një viti kalendarik por vazhdon, veçanërisht në kushtet e gjendjes së mbartur të cash-it i krijuar me burime të ligjshme dhe i deklaruar në vitin 2003 sipas ligjit [...].* Më tej, subjekti i rivlerësimit pranon se: [...] *fakti i mosdeklarimit të pakësimeve ose shtesave nga ana ime të gjendjes cash në DPV-të periodike, nuk ka qenë i qëllimshëm dhe jo për mungesë dëshire/vullneti, por për paqartësi në plotësimin e rubrikës në deklaratimet periodike vjetore të pasurisë lidhur me lëvizjen e gjendjes së cash-it [...].* Subjekti pranon gjithashtu [...] *se është e vërtetë që në deklaratat periodike vjetore nga viti 2004 – 2014 nuk kam deklaruar ndryshime, shtesa apo pakësime të gjendjes cash dhe këto vlera cash të krijuara nga të ardhurat nga pagat dhe kursimet familjare, të deklaruara në DV-2003 dhe shpjegimet shtesë në ILDKPKI... kanë shërbyer për të balancuar të ardhurat përgjatë çdo viti përkatës me shpenzimet e shkollimit të fëmijëve, sipas faturave përkatëse të kryerjes së transfertave/pagesave për shpenzimet e shkollimit të tyre [...], duke i saktësuar dhe deklaruar në procesverbalin dhe shpjegimet shtesë të mbajtura nga ILDKPKI-ja, në mars të vitit 2016, duke argumentuar kështu se nuk ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë financiare<sup>3</sup>.*

2.2 Komisioneri Publik, për sa më sipër, vlerëson se, *për periudhën e marrë në analizë,* i qëndron shkaqeve të ankimit, duke vlerësuar se për qëllim të këtij gjykimi, analiza financiare mbi ligjshmërinë e burimeve të përdorura për shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të subjektit të rivlerësimit duhet të kryhet bazuar në momentin/kohën e depozitimit të shumave në cash, në llogaritë bankare të subjektit, shuma të cilat në vijim duket se janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve të shkollimit të fëmijëve (*referuar transaksioneve të mëtejshme në llogaritë bankare dhe vetë prapësimeve të subjektit në parashtresën e paraqitur në Kolegj, datë 18.9.2023*), vlerësim ky i cili gjen mbështetje edhe në jurisprudencën e Kolegjit për raste të ngjashme, vendimi (JR) nr. 2/2023, prg. 17.8.

2.3 Lidhur me zërat e përfshirë në analizën financiare:

2.3.1 Për zërin “*të ardhurat e bashkëshortes*” nga punësimi pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., në analizë të akteve të reja të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit

---

<sup>3</sup> Për më tepër referohuni aktit “Parashtresë” të subjektit të rivlerësimit, me nr. \*\*\*/\*\* prot., të datës 18.9.2023, pika 1.3, e në vijim, f. 12-15 dhe 23, të tij.

gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, konkretisht: (i) vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë \*\*.6.2022, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe (ii) vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. \*\*\*, datë \*\*.2.2009, Komisioneri Publik vlerëson se këto akte provojnë dhe justifikojnë burimet e deklaruara mbi të ardhurat e bashkëshortes nga punësimi në këto dy shoqëri, dhe si të tilla vlerësohet se të ardhurat e deklaruara duhet të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme për vitet respektive<sup>4</sup>. Për sa i takon pretendimeve të subjektit mbi të ardhurat e bashkëshortes së rivlerësimit sipas shumave të kredituara në llogarinë bankare pranë \*\*\* Bank, Komisioneri Publik, në analizë të pretendimeve të subjektit në parashtrësën e datës 18.9.2023, si dhe provave të vëna në dispozicion gjatë hetimit në Kolegj, i gjen të drejta dhe të bazuara ato, e për pasojë ato duhet të përfshihen në mesin e fondeve në dispozicion të familjes së subjektit të rivlerësimit për vitet respektive, sikundër konfirmuar nga informacioni i bankave të nivelit të dytë.

2.3.2 Për zërin “*kursime në cash*”, Komisioneri Publik, në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në parashtrësas e depozituara në Kolegj datë 18.9.2023, pretendimeve të subjektit gjatë hetimit administrativ të Komisionit, deklarimeve në deklaratat periodike vjetore dorëzuar në ILDKPKI, lexuar këto dhe në harmoni me pretendimet e subjektit mbi referimin në procesverbalet e mbajtura në ILDKPKI, në mars 2016, i gjen ato (pretendimet) të pabazuara dhe vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me kursimet në *cash*, pasi nga aktet rezultojnë se:

(i) Subjekti i rivlerësimit, në deklaramet periodike vjetore nga viti 2004 deri në vitin 2014, nuk ka deklaruar asnjë ndryshim, shtesë apo pakësim, të kursimeve në *cash*.

(ii) Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë \*\*.3.2016, ndër të tjera, i pyetur mbi gjendjen *cash* në datë 31.12.2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: [...] *gjendja cash deri më datë 31.12.2014 është 0 lekë* [...].

(iii) Në DV - 2015, depozituar në ILDKPKI, datë \*\*.3.2016 (pas mbajtjes së procesverbalit të parë në ILDKPKI, datë \*\*.3.2016), subjekti ka deklaruar: [...] *Gjendje cash nga kursimet e të ardhurave të mia dhe të bashkëshortes, të mbartura nga puna e deklaruar për vitin 2015, shuma 1.000.000 lekë* [...].

(iv) Në procesverbalin e dytë (*shpjegime shtesë, datë \*\*.3.2016*), mbajtur në ILDKPKI, me nr. \*\*\* prot., datë \*\*.4.2016, subjekti ka paraqitur në mënyrë tabelore kursimet vjetore si diferencë e të ardhurave – shpenzimeve, paraqitje nga e cila duket se, në fund të vitit 2014, shuma e akumuluar e kursimeve duhej të ishte 4.870.217 lekë.

(v) Në të njëjtin procesverbal, subjekti ka korrigjuar dhe deklarimin e tij të mëparshëm në procesverbalin e datës \*\*.3.2016, duke deklaruar se: [...] *sipas përlllogaritjes plus minus kursimet e mia deri në 31.12.2014 kanë qenë në vlerën 2.500.000 lekë...Gjendja cash e mbetur dhe deklaruar deri më 31.12.2015 është në vlerën 1.000.000 lekë* [...].

(vi) Në prapësimet e tij paraqitur në Kolegj, lidhur me shumat e poseduara në *cash*, për periudhën 2004-2014, subjekti i rivlerësimit në një rast deklaroi se: [...] *theksoj dhe sqaroj se gjendja e cash-it e mbartur në vitin 2003, vit pas viti plus të ardhurat e mia dhe bashkëshortes*

<sup>4</sup> Për të ardhurat e deklaruara nga shoqëria “\*\*\*\*\*” sh.p.k., Komisioneri Publik vlerëson se ato duhet të përfshihen në të ardhurat e vitit 2009 deri në masën e tatimit të paguar.

dhe minus shpenzimet e deklaruara në deklaratat periodike vjetore ka patur rritje dhe ulje, sipas balancës vit pas viti...<sup>5</sup>[...] ndërkohë më poshtë në të njëjtin akt deklarohet se: [...] të gjitha lëvizjet e mjeteve monetare nga gjendja cash në depozita bankare dhe tërheqja e tyre ose transferimi për përbalimin e shkollimit nuk ka cenuar në tërësi gjendjen e mjeteve monetare të disponuara. Në shumicën e rasteve këto nuk pasqyrojnë pakësim të gjendjes së cash-it por lëvizje të brendshme nga gjendja cash në llogari monetare në bankë dhe anasjelltas [...], duke prezumuar dhe, se në disa raste, kursimet janë përdorur dhe zëvendësuar brenda të njëjtit vit kalendarik<sup>6</sup>.

2.4 Sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik<sup>7</sup>, nuk mundësohet kontrolli i pasurisë likuiditete në cash, në periudhën 2004-2014. Nisur nga fakti se kursimet në cash, janë pasuri e luajtshme e tillë që mund të gjurmohen dhe, rrjedhimisht dhe kontrollohen, vetëm nëpërmjet deklarimeve periodike vjetore, si e vetmja formë që mund të provojë ekzistencën e tyre, dhe që përkon më kohën kur kursimet krijohen, shtohen apo pakësohen, Komisioneri Publik vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi përdorimin e kursimeve në cash mbetën të paprovuara dhe në nivel deklarativ.

2.4.1 Referuar dhe jurisprudencës së Kolegjit në raste të ngjashme, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, neni 4, dhe udhëzimet e formularit për plotësimin e deklaratës periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte saktësisht gjendjen financiare të likuiditeteve. Këtë vlerësim, Komisioneri Publik e bazon në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, respektivisht vendimet: (JR) nr. 10/2023, prg. 17.5; (JR) nr. 24/2022, prg. 15.11 e vijim; (JR) 11/2022, prg. 33.12; (JR) nr. 13/2021; (JR) nr. 33/2020; (JR) nr. 11/2019, prg. 27; (JR) 19/2019, prg. 84; (JR) nr. 20/2019, prg. 59; (JR) nr. 29/2019, prg. 31; (JR) nr. 7/2019, prg. 32.5.

2.4.2 Në analizë të pretendimeve të subjektit mbi burimin e të ardhurave për shumat e depozituara në llogaritë bankare (f. 30 e vijim të parashtrimeve), në vlerësimin e Komisionerit Publik, mund të konsiderohet i mbështetur vetëm pretendimi mbi depozitimet e datës \*\*8.2010, mbi përfshirjen në mesin e tërheqjeve të shumës 6.000 euro, tërhequr në cash, datë \*\*3.2010, nga depozita dyemërore, edhe pse në përshkrimin e veprimit/transaksionit bankar specifikohet: [...] tërheqje \*\*\*, \*\*\*, shpenzime për shkollimin e djalit<sup>8</sup> [...].

2.5 Mbi zërin “Shpenzime udhëtimi dhe akomodimi”, Komisioneri Publik vlerëson se pretendimet e subjektit mbi llogaritjen e shpenzimeve të qëndrimit në SHBA, të personave të lidhur, në masën 5 USD/dita, si rrjedhim i jetesës në kampusin e shkollës, mbetën të paprovuara, në konsideratë edhe të kohëzgjatjes së konsiderueshme të qëndrimit në kampus. Rastet e jurisprudencës së deritanishme, që referon subjekti i rivlerësimit, janë raste kur nga

<sup>5</sup> Për më tepër referohuni në f. 24, të aktit “Parashtrësë”, datë 18.9.2023, të subjektit të rivlerësimit.

<sup>6</sup> Për më tepër referohuni në f. 34, të aktit “Parashtrësë”, datë 18.9.2023, të subjektit të rivlerësimit.

<sup>7</sup> Në të dyja variantet e konsiderimit të masës së kursimeve deri në vitin 2003 (3.000.000 lekë apo 5.000.000 lekë).

<sup>8</sup> Përfshirja vetëm e kësaj shume në mesin e burimeve të ligjshme të depozitimeve (pasi shuma 1.055 euro është përfshirë) do të ulte pamjaftueshmërinë e konstatuar në të njëjtën masë (kundërvlerën e shumës 6.000 euro me kursin mesatar të vitit 2010). Bazuar në sa më sipër, pamjaftueshmëria financiare referuar momenteve të depozitimit, sikundër trajtuar, do të arrinte në vlerën negative rreth - 4.600.000 lekë.

pala pritëse është konfirmuar mbulimi i plotë i kostove të akomodimit dhe i ushqimit, shoqëruar kjo dhe me prova/dokumente të rezidencës dhe të ardhurave të realizuara<sup>9</sup>.

2.6 Mbi shkakun ankimor lidhur me depozitimin e shumës 15.000 euro në llogari dyemërore të bashkëshortes së subjektit dhe motrës së saj, në vitin 2010, Komisioneri Publik, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në parashtrimet e datës 18.9.2023, si dhe akteve të vëna në dispozicion lidhur me këto pretendime, i vlerëson ato të drejta. Nga vlerësimi i provave të vëna në dispozicion, lëvizjeve të llogarisë bankare të shtetasës \*\*\*.\*\*\*, konfirmohet sa parashtruar nga subjekti mbi burimin e shumës 15.000 euro.

**3. Lidhur me shkakun ankimor të përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti, për blerjen e apartamentit me sip. 105,1 m<sup>2</sup> dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie**, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij të paraqitura në seancën e datës 18.9.2023, ndër të tjera, mbajti qëndrimin se lidhur me pretendimin për mosdeklarimin e pasjes në pronësi të apartamentit (1+1), në procedurën e përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese, ky shkak ankimi nuk duhet pranuar, pasi gjendja e strehimit të subjektit të rivlerësimit është deklaruar rregullisht prej tij, në zbatim të ligjit të kohës me nr. 7903, datë 8.3.1995, “Për deklarimin e pasurive të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik”, duke e mbështetur këtë prapësim me anë të një prove të re<sup>10</sup> (*deklarata konfidenciale, datë \*\*.03.1996*), administruar nga Kolegji për efekt të këtij gjykimi. Subjekti, po ashtu ka pretenduar se: [...] në kuptim dhe interpretim të pikës 6 të VKM-së nr. 102/1999, të ndryshuar, *Këshilli i Ministrave ka hequr kushtet/kriteret për vlerën e kreditimit në vartësi të gjendjes së strehimit dhe e ka lënë (vlerën e kreditimit), në përputhje me vullnetin e funksionarit përfitues të kredisë të shprehur në kërkesën e paraqitur prej tij [...]*.

3.1 Komisioneri Publik, në analizë të prapësimeve dhe provave të administruara si më lart, gjatë gjyqimit në Kolegj, e vlerëson të drejtë dhe të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për deklarimin real dhe të vërtetë të gjendjes së tij të strehimit, parë kjo në raport me detyrimet që përcaktonte akti nënligjor i kohës, VKM nr. 102/1999, duke vijuar institucionet përgjegjëse më tej kryerjen e procedurës së pranimit të kërkesës dhe lëvrimin të kredisë, duke marrë zgjidhje kjo pjesë e shkakut të ankimit nga hetimi gjyqësor i kryer nga Kolegji.

3.3 *Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament me sip. 105,1 m<sup>2</sup>*, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, lidhur me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën. Subjekti i rivlerësimi ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë në Deklaratën “Vetting”, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a”, e ligjit nr. 84/2016. Deklarimi i subjektit gjatë hetimit administrativ të Komisionit se ka

---

<sup>9</sup> Në vendimin (JR) nr. 11/2019, prg. 27.7, përcaktohet se: [...] *Në kushtet e mungesës së rregullimit të posaçëm ligjor e nënligjor për vlerësimin e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, për subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur me ta, trupi gjykues vlerësoi të arsyeshëm përcaktimin e metodologjisë për përlllogaritjen e këtyre shpenzimeve, si në vijim: Metodologjia për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit/ Shpenzimet e qëndrimit. Shpenzimet e qëndrimit për udhëtime jashtë vendit, për personat e rritur (18+vjeç) llogariten në vlerën 50 euro/dollarë amerikanë për çdo ditë qëndrimi, për fëmijët (5-18 vjeç) 25 euro/dollarë amerikanë për çdo ditë qëndrimi dhe për fëmijët (0 - ditën që mbush 5 vjeç) në vlerën 15 euro/dollarë amerikanë për çdo ditë qëndrimi. Në rastet kur nga subjekti i rivlerësimit provohet se shpenzimet e qëndrimit për të dhe/ose personat e lidhur me të janë mbuluar nga persona të tretë, atij/atyre do t'u llogariten vetëm sasia e të hollave të xhepit prej 5 eurosh/dollarësh amerikanë [...]*.

<sup>10</sup> Shkresa me nr. \*\*\*/\*\*, datë \*\*.9.2023, e Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuar subjektit të rivlerësimit.

përdorur si burim për pagesën e detyrimit 7.346 USD, edhe të ardhurat nga paga dhe ato të përfituara nga shitja e pasurisë në Shkodër, nuk rezulton i mbështetur në prova, për sa kohë ato nuk janë deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike vjetore dhe atë “Vetting”. Pretendimi i subjektit,<sup>11</sup> në parashtrimet ndaj rezultateve të hetimit, se deklarimi i kredisë në vlerën 5.000.000 lekë, si burim krijimi kryesor për blerjen e pasurisë *Apartament me sip. 105,1 m<sup>2</sup>*, në deklaratën periodike të vitit 2003 dhe në atë të “Vetting”, edhe pse në dukje përbën një gabim material, është vlera reale e blerjes<sup>12</sup>, vlerësojmë se nuk qëndron. Në këtë drejtim, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit, mbajmë në konsideratë se, sipas nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, parashikon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, *paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*. Saktësia e deklaratave të subjektit të rivlerësimit është e rëndësishme për të kuptuar gjendjen reale financiare të tij dhe për të vërtetuar nëse ai ka pasur burime të mjaftueshme dhe të ligjshme për krijimin e pasurisë.

4. Komisioneri Publik, për pasurinë *Apartament me sip. 105,1 m<sup>2</sup>*, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, referuar nenit 33, pika 5, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

5. Në përfundim për sa më sipër, duke konstatuar një sërë mangësish, për kriterin e pasurisë, bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve apo vlerësim tërësor të çështjes, rezulton se zbatimi i nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, në rastin konkret, nuk është i bazuar.

## **I. Kërkimi përfundimtar i ankimit**

6. Komisioneri Publik, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 318, datë 3.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Kujtim Luli.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**

---

<sup>11</sup> Subjekti i referohet në këtë rast nenit III të kontratës sipërmarrjes, ku ndërtuesi/sipërmarrësi i kanë kaluar të drejtën për blerjen e disa materialeve/pajisjeve në masën 15% të vlerës së kontratës ose në shumën prej 7.346 USD, të pretenduar prej tij.

<sup>12</sup> Referohuni prapësimeve të subjektit, datë 14.10.2020, f. 8.